



A.nr.2083/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2083/2025, të datës 29.12.2025, të parashtruar nga ankuesja A.S-B, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore “Kaçandolli-Bekteshi”-Valentina Kaçandolli-Bekteshi, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.2083/2025, e datës 21.10.2025, e parashtruar nga ankuesi A.S-B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, A.S-B. (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), me datë 29.12.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8113/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.2083/2025, kundër Vendimit AUV-01/954/1/2025, të Drejtorit Ekzekutiv Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.01.2026, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 20.01.2026, ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kryesuesi i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosijes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2026 dhe numër të protokollit 758/2026 të datës 11.02.2026, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6160/2025 të datës 16.09.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Autorizimin e datës 12.08.2025; Dokument identifikimi i ankueses; Kërkesën e datës 21.08.2025; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01-105/2014 të datës 07.03.2014; Akt emërimit me numër protokolli 1496 të datës 01.04.2014; Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025; Akt emërimit me numër protokolli 1033 të datës 20.03.2012; Vendimin me Nr.Ref.AUV.1-162/2014 të datës 10.03.2014; E-mailin e datës 05.08.2025; E-mailin e datës 29.04.2024;

E-mailin e datës 20.05.2024; Kërkesën me numër protokolli 1293 të datës 01.03.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.09.2025; Përgjigjen në ankesë 25.09.2025; Vendimin me Nr.AUV.01-57/2012 të datës 31.01.2012; E-mailin e datës 07.11.2018; Propozimet e institucioneve në DMZP; E-mailin e datës 16.03.2023; Vendimin me Nr.04/128 të datës 16.02.2023; E-mailin e datës 29.04.2024; Listat e pagave të ankueses; Formularët e vlerësimit të datës: 24.01.2023, 31.01.2024 dhe 28.02.2025; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01/566/2025 të datës 21.07.2025; E-mailin e datës 30.10.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për të hyra vetanake të datës 01.06.2011; Akt emërimit me numër protokolli 1196 të datës 23.03.2012; Akt emërimit me numër protokolli 2997 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.295/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 2998 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.296/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 4728 të datës 07.07.2021; Akt emërimit me numër protokolli 2999 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.297/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 5219 të datës 21.08.2017; Vendimin me Nr.Ref.AUV.01-230/2018 të datës 05.09.2018; Listat e pagave të Koordinatorëve të Zyrave Regjionale (Udhëheqësve); Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës: 10.02.2025; Akt emërimit me numër protokolli 3517 të datës 22.08.2013; Vendimin A.nr.1701/2025 të datës 17.11.2025; Ankesën me numër protokolli 8113/2025 të datës 29.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me Nr.AUV-01/954/1/2025 të datës 05.12.2025; Listat e pagave të vitit 2023; Vendimin me Nr.Ref.295/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 2998 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.296/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 4728 datës 07.07.2021; Akt emërimit me numër protokolli 2999 të datës 08.07.2013; Vendimin me Nr.Ref.297/2013 të datës 08.07.2013; Akt emërimit me numër protokolli 5219 të datës 21.08.2017; Vendimin me Nr.Ref.AUV, 01-320/2018 të datës 05.09.2018; Përshkrimin e detyrave të punës së Koordinatorit të Zyrës Regjionale; Pesë (5) Formularët e vlerësimit të punës të datës 10.02.2025, të Udhëheqësve të Zyrave Regjionale; Listat e pagave të muajit janar 2023, për nëpunësit në pozitën koordinator i zyrës regjionale në AUV; Akt emërimit me numër protokolli 3417 të datës 22.08.2013; Vendimin me numër protokolli 3512 të datës 22.08.2013; Vendimin me numër protokolli 5325 të datës 22.07.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses është **e pasafatshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përkatësisht sipas Vendimit me Nr.01-57/2012 të datës 31.01.2012, nga pozita *Zyrtare e të hyrave-Zotuese*, është caktuar në pozitën *Zyrtare e Lartë për të Hyrat Vetanake dhe Zotues*, për të cilën pozitë në Sektorin/Njësinë e Buxhetit dhe Financave të Drejtorisë së Administratës, të njëjtës me datë 20.03.2012, i është lëshuar Akt emërimi me numër protokolli 1033.

Më tej, sipas Vendimit me Nr.Ref.AUV.01-105/2014 të datës 07.03.2014, të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ankuesja është caktuar në pozitën *Koordinatorë për të hyra* në Drejtorinë për Administratë, me koeficient të përcaktuar të pagës **nëntë (8)**, mirëpo i cili Vendim është shfuqizuar sipas pikës V të dispozitivit të Vendimit me Nr.Ref.AUV.01-162/2014, të datës 10.03.2014, të Kryeshefit Ekzekutiv të AUV-it, ku si rrjedhojë ankuesja është caktuar në pozitën e njëjtë atë Koordinatorës për të hyra, por se në pikën II është përcaktuar koeficienti **tetë (8)**. Ndërsa, me datë

01.04.2014, rezulton se ankueses i është lëshuar Akt emërimi me numër protokolli 1496, për këtë pozitë pune me koeficient të pagës **tetë (8)**.

Tutje, me datë 21.08.2025, ankuesja ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 6222, pranë organit përkatës të punësimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës nga koeficienti 8 në koeficientin e pagës 9, si dhe po ashtu pozitën e së njëjtës Koordinatorë për të hyra, ta klasifikoj në kategorinë drejtues i ulët me koeficient të pagës 7.35.

Ndërsa, U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, ka njoftuar ankuesen duke theksuar se citoj: “ *Për më shumë sipas kërkesës, nëpërmjet e-mail, me datë 05.08.2025, Sektori i Personelit të AUV ka njoftuar znj. S-B: DMZP/Thesari nuk ka aprovuar propozimin e Sektorit të Personelit të AUV për korrigjim të kategorisë së pozitës Koordinator për të Hyra nga profesional 1 në Drejtues i ulët, si dhe nuk ka aprovuar propozimin për korrigjim të koeficientit në 7.35 për pozitën Koordinator për të hyra.* ”

Ankuesja, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli 6364 të datës 27.08.2025, kishte parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet se zyrtarët tjerë të sistemuar në pozitën e njëjtë/Koordinator, janë paguar me koeficient të ndryshëm, gjegjësisht me koeficient 9, dhe se me këtë rast e njëjta është diskriminuar nga organi përkatës i punësimit, si dhe po ashtu e njëjta konteston përgjigjen përkatëse për nga struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, ashtu që kërkon nga Këshilli aprovimin e ankesës, me detyrimin që organi i punësimit të rishqyrtoj kërkesën e datës 21.08.2025, të parashtruar nga ankuesja.

Këshilli, përmes Vendimit A.nr.1701/2025 të datës 17.11.2025, ka shfuqizuar Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 6364 e datës 27.08.2025, e U.D Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa lëndën e ankueses, e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Vendimit AUV-01/954/1/2025, të datës 05.12.2025, ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore për rishikimin e gradës dhe kompensimin sipas kërkesës së ankueses.

Ankuesja, e pa kënaqur me vendimin e lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore për aprovimin ankesës, ashtu që të obligohet Drejtori Ekzekutiv dhe U.D Udhëheqësja e Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, që ankueses ti brenda afatit 15 ditor, ti bëhet kompensimi në emër të diferencës së koeficientit nga tetë (8) në nëntë (9), nga data e lëshimi të Aktit të emërimit të datës 01.04.2014 e deri më datën 21.08.2025, kur ankuesja ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit, si dhe të njëjtës ti ndryshohet akti i emërimit në pajtim me katalogun e vendeve të punës.

Kolegji i Këshillit, duke marrë parasysh se organi punësimit në këtë rast Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka vendosur në ri procedurë sipas Vendimit A.nr.1701/2025 të datës 17.11.2025, ndaj lidhur

me pranueshmërinë e ankesës për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës nga tetë (8) në nëntë (9), nga data e lëshimi të Aktit të emërimit të datës 01.04.2014 e deri më datën 21.08.2025, i' u referuar legjislacionit të aplikueshëm, në kohën e lëshimit të Aktit të emërimit me numër protokolli 1496 të datës 01.04.2014, për pozitën e ankueses Koordinate për të hyra në Drejtorinë për Administratë, mbi bazë të cilit e njëjta kërkon realizimin e të drejtës së pretenduar, përkatësisht dispozitave të:

-Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, i cili me nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 81 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar se: *"1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike. Neni 81: 1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.*

-Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku me nenin 4 paragrafi 1, parashihej se: *1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës; , nenin 8 paragrafin 2: Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit brenda tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.*

-Ligjin Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, ku me nenin 130 paragrafi 130.1 pika b ka përcaktuar: *130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi,*

Andaj, në kontekst të kuadrit ligjor si më lart dhe referuar Aktgjykimit A.rev.nr.74/2025 të datës 26.01.2026 të Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa lidhur me pretendimet ankimore për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës nga tetë (8) në nëntë (9), nga data e lëshimi të Aktit të emërimit të datës 01.04.2014 e deri më datën 21.08.2025, është e parashtruar në kundërshtim me afatet e përcaktuar me dispozitat e cekura më lartë, dhe si e tillë ankesa është e jashtëafatshme, në kuptim të nenit 130 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, për faktin se ankuesja ka humbur afatet ligjore për kundërshtimin e koeficientit të pagës së përcaktuar me aktin e emërimit përkatës, të cilin e njëjta rezulton se e ka nënshkruar pa vërejtje, gjegjësisht ankuesja realizimin e pagës bazë apo kompensimin material në mënyrë retroaktive për pozitën që ushtron, rezulton se nuk e ka kundërshtuar apo ankimuar deri në parashtrimin e kërkesës me numër protokolli 6222 të datës 21.08.2025, e cila kërkesë po ashtu edhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës; ndërlidhur me nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me realizimin e kompensimit material në mënyrë retroaktive është e parashkruar, për faktin se periudha kohore e kësaj kërkesë nga marrëdhënia e punës në para apo në mjete financiare, përbënë një periudhë kohore prej më shumë se dhjetë (10) viteve kalendarike, ndërsa, nga shkresat e lëndës, përkatësisht sipas kërkesës me numër protokolli 1293 të datës 01.03.2024, është fakt i pakontestueshëm se ankuesja ka qenë e njoftuar lidhur me përcaktimin e koeficienteve të pozitës*

Koordinator i Zyrës Regjionale, përkatësisht nivelizimit të pagave dhe emërimit të tyre në kategorinë Drejtues i Ulët, ashtu që me këtë rast e njëjta ka kërkuar ekuivalentimin e koeficientit bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e saj të pozitës përkatëse që mbanë.

Lidhur me pretendimin ankimor, për ndryshimin e aktit të emërimit në pajtim me katalogun e vendeve të punës, Kolegji i Këshillit sjellë në vëmendje se me Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, mirëpo me të cilin janë paraparë vetëm pozitat e kategorisë profesionale të Shërbimit Civil, nga rezulton se pretendimi si i tillë është kundërthënës me kërkesën e realizimit të kompensimit të diferencës së pagës ndërmjet koeficientit të pagës bazë të pozitës profesionale dhe asaj drejtuese të ulët, si dhe me kërkesën me protokollin 1293 të datës 01.03.2024, e duke shtuar këtu faktin se organi i punësimit, në këtë rast Agjencia për Ushqimin e Veterinarisë ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe se mbi këtë gjendje faktike dhe juridike, pretendimi ankimor i ankueses për ndryshim të aktit të emërimit, pa përfunduar ende procesi i klasifikimit të vendeve të punës në organin përkatës të punësimit, nuk mund të trajtohet, ngase klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.2083/2025, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankueses që e njëjta pas përfundimit të klasifikimit të vendeve të punës në organin punëdhënës, gjegjësisht pas procesit të ristrukturimit të ushtrij ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.2083/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësueses së autorizuar të ankueses, Valentina Kaçandolli-Bekteshi;*
- *U.D Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*